

LIGJ
Nr.8335, datë 23.4.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8224, DATË 15.5.1997 "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E POLICISË SË BASHKISË DHE TË KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8224, datë 15.5.1997, në nenin 1, paragrafi i parë, fjala "përkatësisht" ndryshohet dhe zëvendësohet me fjalët "Për detyrat që kryen, ajo është".

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si vijon:

"Policia e bashkisë dhe e komunës, si rregull, ka këtë strukturë:

- inspektori - shefi i seksionit të policisë në bashki ose në komunë;

- policë.

Në këshillin e rrethit emërohet kryeinspektori i rrethit për policinë e bashkisë e të komunës."

Neni 3

Në nenin 3, paragrafi i parë, fjalët "Ministri i Brendshëm" zëvendësohen me fjalët "Drejtori i Përgjithshëm i Policisë".

Në paragrafin e dytë, pas fjalëve "Ai kryen me autorizim të prokurorit edhe funksione" shtohet fjala "të oficerit".

Neni 4

Në nenin 5, fjala "oficerët" ndryshohet me fjalët "shefin e seksionit dhe inspektorët".

Neni 5

Në nenin 8, pika 1, fjala "urdhrave" zëvendësohet me fjalën "akteve" dhe fjala "vendimeve" hiqet.

Pika 9 ndryshohet si vijon:

"Të inspektojë respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shitblerjes në mjedise publike".

Pika 14 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 11, pas fjalëve "në mjediset e Policisë" shtohen fjalët "të bashkisë ose të komunës".

Neni 7

Neni 12 ndryshohet si vijon:

"Kryeinspektori i rrethit për policinë e bashkisë dhe të komunës ka në vartësi edhe

inspektoratin e Mbrojtjes nga Zjarri, i cili funksionon në nivel rrethi."

Neni 8

Në nenin 14, pas fjalëve "policia e shtetit," shtohen fjalët "e cila miratohet nga ministri për Pushtetin Lokal".

Neni 9

Në nenin 19, pas fjalëve "Ministri i Brendshëm" shtohen fjalët "dhe Ministër për Pushtetin Lokal".

Neni 10

Në të gjitha nenet të ligjit nr.8224, datë 15.5.1997 fjalët "Ministri Brendshëm" zëvendësohen me fjalët "Ministri i Rendit Publik" "Sekretari i Shtetit për Pushtetin Lokal" zëvendësohet me fjalët "Ministri për Pushtetin Lokal" dhe fjala "komandanti" zëvendësohet me fjalët "kryeinspektori i rrethit për policinë e bashkisë e të komunës".

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2080, datë 8.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani